32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit, dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) PAGESA e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

(f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatuar periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një çertifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi nenit	i Neni. Nr.	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	i 2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Siguria ekzekutimit	e 10.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % vlerës së parashikuar (110.000,00€) për kohëzgjatjen e periudhës prej 37 muajve .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000

		<p>euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar</p> <p>(ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë <i>[shëno numrin]</i> ditë kalendarike.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.
		Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahet në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës
Parimet e përgjithshme të pagesave	24	<p>Kërkesat për pagese do të bëhen për punët e përfunduara në baza mujore (ex post).</p> <p>Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për punët e përfunduara në baza mujore (ex post). Në bazë të konstatimit të Menaxherit dhe ekipit mbikëqyrës.</p>

		Nuk ka pagese paraprake
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve (3vite).
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 3 vite .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të

	<p>dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
--	--

RENOVIME, PËRMISIME TE INFRASTRUKTURËS SË OBJEKTEVE SHËNDETËSORE NE KOMUNEN E PRISHTINES

KUSHTET E PERGJITHSHME					
<p>1. Përshkrimi i punëve: Ne perputhshmeri te plote me normat dhe standartet EC dhe ISO.</p> <p>2. Gjitha pozicionet në këtë paramasë nënkuptojnë që në çmim duhet të llogaritet furnizimi me material, transportin, shkarkimin, vërja në vepër e materialit sipas standardeve dhe normave që rregullojnë ato me të gjitha elementet përcjellëse për ekzekutim (skele, masat mbrojtëse për siguri në punë etj).</p> <p>3. Masat e sigurisë: Duhet të jete në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shendetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këte mënyre duhet të bëhet rrethimi- sigurimi sa me i mire i punishtes dhe vendosjes e materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapsinore në mes të zonës nën ndërtim (RENOVIM) dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtes. Punishtja të rrethohet me tabela prej llamarine dhe me konstruksion të përforcuar mirë në toke. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikucjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin te instalimeve egzistuese te cilat ngelen ne sherbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.</p> <p>4. Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakterisika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standartet EC dhe ISO.</p>					
GRUPI I 50%					
1	PUNET PËRGADITORE	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma (€)
1.1	Preventiva hapsinore ne mes te zones nen nderitim (renovim) dhe zonave tjera ne afersi. Sip. Sp. Teknik.	komplet	1.00	15.00	15.00
1.2	Pastrimi i objektit, pozicioni përfshinë, grumbullimin, paketimin si dhe largimin e të gjitha paisjeve medicinale dhe medikamenteve të vjetra nga objekti deri në deponinë e caktuar nga investitori.	komplet	1.00	15.00	15.00
Shuma 1:					30.00
2	DEMOLIMET				
2.1	Demolimi (largimi) i shtresës së ngjyrës dhe gletit në mure dhe tavan. Pozicioni parasheh të gjitha punët e nevojshme demoluese si dhe transportimin e materialeve të demoluara deri në deponit e caktuara nga ana e investitorit në largësi minimale 5 km nga punishtja.	m ²	1.00	15.00	15.00
2.2	Demolimi i mureve (t= 25cm) për krijimin e hapësirës për derë. Pozicioni përfshinë edhe largimi i mbeturinave ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km.	m ²	1.00	15.00	15.00
2.3	Demontimi i dyerve dhe dritareve ekzistuese nga materiali I (Drurit, PVC, Alumin, ose Hekur). Pozicioni përfshinë edhe largimi e tijë ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km.	m ²	1.00	15.00	15.00
2.4	Demontimi i dritareve ekzistuese nga materiali I (Drurit, PVC, Alumin, ose Hekur). Pozicioni përfshinë edhe largimi e tijë ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km.	m ²	1.00	15.00	15.00



2.5	Demolimi për krijimin e hapësirës 90/210 me trashësi 38 cm sipas projektit. Pasi që muri ekzistues është muri mbajtës ky demolim duhet të realizohet në faza dhe atë si vijon: 1. Faza 1 - Krijimi i hapësirës për akri tra në anë e jashtme (koridori) deri në thellësinë 18 cm dhe lartësinë 25cm dhe gjëresi 130 cm ky do të vendoset profili HOP 200/150/4.2. Faza 2 - Krijimi i hapësirës për akri tra në anë e mbrendshme (dhoma) deri në thellësinë 18 cm dhe lartësinë 25cm dhe gjëresi 130 cm ky do të vendoset profili HOP 200/150/4. 3. Faza 3 - Pas montimit të arkitrajeve bëhet demolimi i komplet murit për hapësirën e derës. Pozicioni përfshinë edhe largimi i mbeturinave ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km. Vërejtje: Në çmim nuk është paraparë vendosja e arkitraut.	komplet	1.00	35.00	35.00
2.6	Demolimi, pastrimi i dyshemese per shtresat e reja te objektit, pozicioni përfshinë të gjitha shtresat e dyshemeve deri në nivel të pllakës beton arme sipas projektit dhe largimi i mbeturinave ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km. Te gjitha dyshemet qe do te demolohej te llogariten me te gjitha shtresat deri ne pllaken e betonit duke përfshirë edhe gypat e ujit dhe kanalizimit dhe instalimeve tjera nëse ka. Te pregalitjet hapësira per vendosjen e dyshemes se re.	m ²	1.00	34.00	34.00
2.7	Demolimi i fasades ekzistuese me te gjitha elementet deri ne konstruksiom. Ne llogari meret edhe transporti i mbetjeve deri ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres.	m ²	1.00	16.00	16.00
2.8	Grryerja e sipërfaqes së ngjyrës, gletit, pllakave të qeramikës si dhe suvatimit në mure , pozicioni përfshinë edhe pastrimin e punishtës gjatë gjithë kohës së realizimit të këtijë aktiviteti si dhe largimi i mbeturinave ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km	m ²	1.00	25.00	25.00
2.9	Grryerja e sipërfaqes së ngjyrës, gletit në tavan, pozicioni përfshinë edhe pastrimin e punishtës gjatë gjithë kohës së realizimit të këtijë aktiviteti si dhe largimi i mbeturinave ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km	m ²	1.00	15.00	15.00
2.1	Çmontimi i elementeve ne banjo si dhe kuzhinë, ne pozicion përfshihet heqja e te gjitha elemntve te cilat gjenden ne hapsirat e banjove dhe kuzhinës. Largimi dhe deponimi i ketyre elementeve te cilat jane ne gjendje te mire te percaktohet nga personi zyrtar, ndersa elementet e panevojshme te dergohen ne deponi jo me afer se 5km.	copë	1.00	15.00	15.00
2.11	Demolimi i sallobankut, ulluqeve vertikale si dhe horizontale. Pozicioni përfshinë edhe transportin deri ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km.	m'	1.00	22.00	22.00
2.12	Demolimi i trotuarit, rampës për hendikep si dhe pllakës betonarme rreth objektit dhe në oborr. Pozicioni përfshinë edhe transportin deri ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km. llogaritja e sipërfaqes behet ne baze të themelit	m ²	1.00	15.00	15.00
2.13	Demolimi i rrethojës ekzistuese nga profilet e çelikut në hyrje të objektit. Pozicioni përfshinë edhe transportin deri ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km	m'	1.00	35.00	35.00
3.4	Demolimi i mbulesës së kulmit. Pozicioni përfshinë të gjitha shtresat e kulmit, konstrikionin si dhe transportin e mbeturinave ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km. Vërejtje: Nëse mbulesa e kulmit është prej asbest betonit (sallonit), në çmim duhet të parashihen të gjitha shpenzimet për transportin si dhe deponimin e tyre nën kushte të veçanta në përputhje me udhëzimet të dhëna nga MMPH.	m ²	1.00	35.00	35.00



3.5	Demolimi i instalimit elektrik, ku përfshihen të gjitha elementet e sistemit elektrik. Pozicioni edhe transportin e mbeturinave ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km	komplet	1.00	50.00	50.00
3.6	Pastrimi i terenit, pozicioni përfshinë largimin e barishtave, shkurreve si dhe gërmimin deri në thellësinë 30 cm. Largimi i mbeturinave ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres, jo me pak se 5 km.	m ²	1.00	14.00	14.00
				SHUMA 2	371.00
3	PUNIMET E MURATIMEVE				
3.1	Vërejtje: Në çmim për muratim me blloka të argjilës duhet të parashihet edhe brezi shtangues 25x25 cm; 20x25 cm si dhe 12x25 cm (në varësi të trashësisë së murit i cili punohet me beton të armuar -Klasa C25/30 dhe i armuar me armaturë 2Ø12 -Trau shtangues vendoset mbi nivelin e dyerve dhe dritareve. Te gjitha pozicionet përfshijnë edhe materialin lidhës, skelet si dhe pastrimin e vendit pas realizimit të këtijë aktiviteti. Gjitha muret me gazbeton (poroz beton) para suvatimit duhet te vendosur rrjeta me ngjitesë.				
3.1	Furnizimi dhe montimi i mureve ndarese nga gips kartoni me trashësi 15cm. Nga te dy anet e jashtme duhet te vendosen 1x1 pllaka nga 12.5mm zjarrëqendruese, ndersa ne mes duhet vendosur konstruksioni metalik si dhe shtresa nga leshti mineral per izolim termik dhe akustik. Klasa e qendrueshmerise nga zjarri T90, mbrojtja nga zhurma 54dB.	m ²	1.00	20.00	20.00
3.2	Furnizimi me material si dhe punimi i murit ndarës me blloka prej argjille GITER me trashësi 25 cm, pozicioni përfshinë edhe materialin lidhës, skelet si dhe pastrimin e vendit pas realizimit të këtijë aktiviteti.	m ²	1.00	12.00	12.00
3.3	Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe te zbrazëta me trashësi deri 25 cm.	m ²	1.00	12.00	12.00
3.4	Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe të zbrazëta me trashësi deri 12.5 cm.	m ²	1.00	12.00	12.00
3.5	Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe të bardha (poroz beton i lehtë) me trashësi deri 25 cm.	m ²	1.00	14.00	14.00
3.6	Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe të bardha (poroz beton i lehtë) me trashësi deri 20 cm.	m ²	1.00	13.00	13.00
3.7	Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe të bardha (poroz beton i lehtë) me trashësi deri 12.5 cm.	m ²	1.00	13.00	13.00
3.8	Furnizimi me material muratimi i mureve nga tullat e plota me me trashësi deri 25 cm.	m ²	1.00	9.00	9.00
3.9	Furnizimi me material muratimi i mureve nga tullat e plota me me trashësi deri 12.5 cm.	m ²	1.00	9.00	9.00
3.10	Furnizimi me material muratimi i mureve me pllaka gipsi me konstruksion që ngjiten për murin ekzistues me një shtrese.	m ²	1.00	13.00	13.00
3.11	Furnizimi me material muratimi i mureve me e pllaka gipsi me konstruksion nga të dy anët me nga një pllakë, hapësira në mes të pllakave mund të shkoj deri 25 cm (pllaka gipsi rezistente ndaj lagështisë).	m ²	1.00	20.00	20.00
3.12	Furnizimi me material dhe punimi i tavaneve me pllaka gipsi me konstruksion (pllaka gipsi rezistente ndaj lagështisë). 60x60cm	m ²	1.00	53.65	53.65
3.13	Furnizimi me material dhe punimi i tavaneve me sistemin armstrong me konstruksion 60x60cm , nga materiali alumin	m ²	1.00	39.65	39.65
3.14	Furnizimi me material dhe punimi me kontakt beton para vendosjes së suvasë.	m ²	1.00	9.25	9.25



				Shuma 3:	249.55
4	PUNET E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES				
	Siperfaqja eshte e kalkuluar bruto perfshire shpaletat, kendoret e nevojshme nga prodhuesi, fugat e dilatimit per fasade, kendoret me ngjites nga PVC rreth dritareve - hapjeve. Hapjet zbriten nese jane me te medha se 2m ² (vetem hapjet deri ne 2m ² llogariten ne siperfaqe bruto). Ne kete pozicion perfshihen edhe te gjitha materialet dhe punet përcjellëse të nevojshme për realizimin e aktiviteve. Te gjitha pozicionet përfshijnë edhe materialin lidhës, skelet si dhe pastrimin e vendit pas realizimit të këtijë aktiviteti.				
4.1	Suvatimi i mureve te brendshme dhe plafonit te objektit në minimum dy shtresave, me llaq-suva te parapergaditur i aplikueshem me makine sperkatese per llaq-suva.	m ²	1.00	9.75	9.75
4.2	Furnizimi me material si dhe rrafshim i siperfaqeve të mureve dhe plafoneve me Glet Masë, pozicioni përfshinë minimum dy shtresa të gletit	m ²	1.00	14.65	14.65
4.3	Ngjyrosja e mureve ne dy shtresa. Ngjyrë disperzive e kualitetit të lartë me bazë akrylike, ekologjike dhe yndyrore, ne lartesi te caktuar nga organi mbikqyres- Dedikuar për dekorimin e mureve të brendshme dhe të jashtme,- Lehtë i aplikueshëm, difuz në ujë dhe ajër,- I qëndrueshëm në fërkim dhe pastrim me leckë,- I përshtatshëm për nuancim,- Pa materie që avullohen	m ²	1.00	9.50	9.50
4.4	Ngjyrosja e tavanit ne dy shtresa. Ngjyrë disperzive e kualitetit të lartë me bazë akrylike, ekologjike.- Dedikuar për dekorimin e mureve të brendshme dhe të jashtme,- Lehtë i aplikueshëm, difuz në ujë dhe ajër,- I qëndrueshëm në fërkim dhe pastrim me leckë,- I përshtatshëm për nuancim,- Pa materie që avullohen	m ²	1.00	9.00	9.00
4.5	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e murit me ngjyre: plastike anti-myk te cilesisë se larte.	m ²	1.00	9.00	9.00
4.6	Pastrimi i parrakeve ekzistues -largimi i ngjyre ekzistuese, furnizimi me material dhe ngjyrosja e te njejteve me ngjyrë në dy shtresa ngjyrë per mbrojtje te drurit. Llogaritet ne m1 te marmakut te shkalleve dhe ballkoneve.	m1		25.00	25.00
4.7	Pastrimi i parrakeve ekzistues nga ndryshku dhe ngjyra ekzistuese, furnizimi me material dhe ngjyrosja e te njejteve me ngjyrë antikorozion dhe dy shtresa ngjyrë metalike mbrojtese te metaleve. Llogaritet ne m1 te marmakut te shkalleve dhe ballkoneve.	m1		25.00	25.00
				Shuma 4:	101.90
5	PUNET E FASADËS				
	Siperfaqja eshte e kalkuluar bruto perfshire shpaletat, kendoret e nevojshme nga prodhuesi, fugat e dilatimit per fasade, kendoret me ngjites nga PVC rreth dritareve - hapjeve. Hapjet zbriten nese jane me te medha se 2m ² (vetem hapjet deri ne 2m ² llogariten ne siperfaqe bruto). Ne kete pozicion perfshihen edhe te gjitha materialet dhe punet përcjellëse të nevojshme për realizimin e aktiviteve. Te gjitha pozicionet përfshijnë edhe materialin lidhës, skelet si dhe pastrimin e vendit pas realizimit të këtijë aktiviteti.				



5.1	Furnizimi, transportimi dhe punimi i "demit fasades" me trashësi te termoizolimit d=-12cm , me fortësi N4, duke përfshirë edhe montimin dhe demontimin e skeleve. Duke përfshirë: Rrjeta" Rabic", Llaq per suvatim fasade" Renofix" ose te ngjajshme, Njyrosja e fasades me ngjyre diprezive e kualiteti te larte per muret e jashtme e qendrushme ndaj ndryshimeve klimatike. Eshle Hidrofobe, e qëndrueshme ndaj rrezeve të diellit dhe ka arome te lehte, lloji "Ega Farbe" apo te ngjajshume. të përfshihen të gjitha pozicionet per realizimin e pozicionit. (komplet)	m ²	1.00	43.25	43.25
5.2	Furnizimi me material si dhe mveshja e mureve të serklazhit me terraplast deri në lartësinë 60 cm	m ²	1.00	22.00	22.00
5.3	Furnizimi dhe montimi punimi i solbankës nga mermeri. Pjesa e jashtme e solbankës këndet duhet të jenë të përpunuara në formë rrethore dhe pjesa e poshtme duhet të ketë pikore. Solbanka nga jashtë duhet të jetë 4cm e dalur (nxjerr) nga rrafshi i fasadës. Po ashtu nga anësoret duhet të jetë e dalur (nxjerr) nga 4cm. Anët e jashtme të solbankës duhet të jenë të përpunuara në formë gjysmërrethore, Trashësia e solbankës duhet të jetë 3cm. (llogaritja matjet bëhen në sipërfaqen e jashtme, (4cm+A+4cm)X(B+4cm)).	m ²	1.00	48.00	48.00
5.4	Furnizimi dhe montimi punimi i solbankës nga graniti. Pjesa e jashtme solbankës këndet duhen të jetë të përpunuara në formë rrethore dhe pjesa e poshtme duhet të ketë pikore. Solbanka nga jashtë duhet të jetë 4cm e dalur nga rrafshi i fasadës. Po ashtu nga anësoret duhet të jetë e dalur (nxjerr) nga 4cm. Anët e jashtme te solbankës duhet të jenë të përpunuara në formë gjysmërrethore. Trashësia e solbankës duhet të jetë 3cm. (llogaritja matjet bëhen në sipërfaqen e jashtme, (4cm+A+4cm)X(B+4cm)).	m ²	1.00	48.00	48.00
5.5	Furnizimi me material si dhe punimi i solbankës jashtme te dritareve me llamarinë me trashësi 0.8mm, perfishi ngjitesin, mbushjet siguruse per silikon, formimin e pikoreve me dalje 30mm, vija e pikores dhe aksesoret percjelles per kompletim.	m ²	1.00	34.00	34.00
				Shuma 5:	195.25
6	PUNET E DYSHEMESË				
6.1	Furnizimi me material dhe shtruarja e estrih betonit me trashësi 5 cm, me armature rrjetë Ø4/15 cm dhe PV Folie (Verejtje: estrih betoni duhet ta mbrije fortësinë e nevojshme). Lageshtia e esitrihut para shtrirjes se dyshemese duhet të jetë < 4%.	m ²	1.00	11.55	11.55
6.2	Furnizimi me material dhe shtruarja e shtreses vetenivelizuese nga baza e çimetos me fortësinë e nevojshme per sanimin e sipërfaqeve te demtuara. Lageshtia e esitrihut para shtrirjes se dyshemese duhet të jetë < 4%.	m ²	1.00	11.25	11.25
6.3	Furnizimi me material si dhe punimi i shtresës së dyshemes me styropor, d=50mm (30mm+20mm) - N4, (izolimi). Ne pozicion te përfshihet edhe folia e PVC si dhe shiriti ndares ne mes murit dhe dyshemes.	m ²	1.00	4.75	4.75



6.4	Furnizimi me material si dhe punimi i dyshemesë me epoksit, i cili realizohet me rrëshirë epoksite vetnivelizuese, e pigmentuar, 2 komponente me forcues aminik i modifikuar e paracaktuar kryesisht për subtrakte prej çimento që janë shumë të ngarkuara kimikisht dhe mekanikisht, psh. Depo, laboratore, spitale, industri ushqimore, salla për prodhim, garazha etj. Në gjendje të ngurtë duhet të jetë shumë e fortë elastike rezistence në harxhim në acide, vajra minerale. Lloji i rrëshirës epoksite vetnivelizuese përfundimtare duhet të jetë rezistente në acide, pozicioni i përshinë këto aktivitete: - Pastrimi i dyshemesë nga pluhuri Sistemi i dyshemesë epoksite (trashësia 1.5mm) realizohet me shtresat si vijon: Së pari lyhet dyshemeja me lyerje epoksite bazë , dy shtresa lyerje me material epoksit përfundimtar i përzier me rërë kuarci (ES-epoxy sand) si dhe një shtresë përfundimtare epoksite. Vendosija e epoksitit duhet të behet konform Standardit EN 13813. Në çmim duhet të përfshihen edhe llajsnat kendoret si dhe të gjithamaterialet dhe punet tjeta të nevojshme për të arritur produktin final	m ²	1.00	57.55	57.55
6.5	Furnizimi me material si dhe punimi (mbulimi) final i dyshemes me Lineleum me trashësi d=4.0mm, pozicioni përshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme për kompletimin e këtijë aktiviteti, përfshi saldimin, punimin e llajsnave h=10cm dhe gjithë aksesoret e tjere.	m ²	1.00	49.65	49.65
6.6	Furnizimi me material dhe montimi i hidroizolimit të ftohte dy komponentsh në dysheme, në nryen sanitare me ngritje në mure në lartësi minimale 50 cm, kjo përshinë tharjen e dyshemesë, Llogaritja në m ² të sipërfaqes së punuar.	m ²	1.00	11.25	11.25
6.7	Furnizimi me material dhe montimi i hidroizolimit (me kondor 3mm+ 4mm) në dysheme të objektit, kjo përshinë tharjen e dyshemesë ,lyerjen me shtresë bazë si dhe një shtresë bitumen, Llogaritja në m ² të sipërfaqes së punuar	m ²	1.00	3.65	3.65
6.8	Furnizimi dhe instalimi i pllakave të murit nga porcelani Klasi i pare, dy her të pjekura sipas EN 14411:2004(ISO 13006), Fortesija min. 50N/mm ² sipas UNI EN ISO 10545-4.Rezistenca ndaj abrazionit të permbush kushstet sipas UNI EN ISO 10545-6.Rezistenca ndaj Ngricave duhet të takoj grupit Bla Klasa(UGL) sipas UNI EN 14411,Apsorbimi i ujit duhet të jete me e ulet se 0.5%,Rezistenca ndaj acideve dhe bazave sipas NI EN ISO 10545-13.Vendosija e pllakave duhet të behet konform Standardit EN 13888.Në çmim duhet të përfshihen edhe kendoret e Aluminit,ngjitsi, dhe të gjitha punet tjeta të nevojshme për të arritur produktin final. Dimensioi dhe ngjyra percaktohet nga organi mbikqyres	m ²	1.00	53.25	53.25
6.9	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave të granitit natyral me trashësi 2cm në hyrje të objektit. Përzgjedhja e llojit dhe ngjyres se pllakave caktohet sipas kërkesës së investitorit.Në çmim janë të përfshira edhe të gjitha kendet e nevojshme prej alumini si dhe coklla me lartësi 8 cm. Montimi të behet me llaç çimentoje dhe të behet rinivelizimi i dyshemesë	m ²	1.00	48.65	48.65
6.10.	Furnizimi me material si dhe montimi i laminatit me trashësi jo me të vogël se t=8mm.Disajni ndhe ngjyra caktohet nga organi mbikqyres. Në çmim të përfshihet edhe folia absorbuese si dhe llajsnat perimetrike.	m ²	1.00	31.25	31.25
				Shuma 6	282.80

50%

7	PUNËT E ZDRUKTHTARISË Në pozicion parashihet edhe furnizimi me material si dhe narmimi (sanimi) i perimetrit të dyerve dhe dritareve ekzistuese. Pozicioni përshinë të gjitha materialet dhe punimet e nevojshme që ky aktivitet të jet funksional. Të gjitha llojet e materialeve duhet të jen identike me ato ekzistuese si në pjesën e mberishme të objektit po ashtu edhe në fasadë. Verejtje: Harrnimi (sanimi) të realizohet me kujdes me qëllim që të mos dëmtohet fasada e jashtme e objektit.				
---	--	--	--	--	--



7.1	Furnizimi dhe Instalimi i dyerve te kualitetit te larte per përdorim te shpeshte Krahu i derës: izolimin iver mbushje me perforim tubular, mbëshjellës metal: te galvanizuar me trashësi min 0.9mm dhe me ngjyrosje pluhur termike, 40mm të trasha. Dy bagllame tre-pjeseshe dhe dorezën e lakuar ne skaje. Korniza: Ilmarine 2mm te galvanizuar dhe me ngjyrosje pluhur termike, me ankerë për mure, min. 22cm te thellë. Gome mbylljeje ne tri ane. Koeficienti i rezistencës ndaj zjarrit T30 min. Izolimi e nxehtësisë ud = 1.9ë (m² K). Izolimi akustik në përputhje me EN 20140/717-1 deri në Rë 48dB. Dera duhet të jetë me ngjyre të bardhë RAL 9016. Dyerit duhet te kene cilindrin dhe celesat per mbyllje dhe hapje te tyre. Hapja sipas skemave. Masat te mirren ne vend. Shiqo skemat. Vërejtje: - Pozicioni përfshinë edhe harrnimin si nga pjesa e jashtme (fasada) dhe nga pjesa e mbrendshme rreth derës në hyrje të objektit- Të gjitha masat të mirren në vend. Ngjyra caktohet nga organi mbikëqyrës. sipërfaqja llogaritet për m². Vërejtje: Të gjitha masat të mirren në vend.	m2	1.00	145.00	145.00
7.2	Furnizimi dhe instalimi i dyerve dhe dritareve nga PVC profilet . Min. 8cm trashësi te profilit, me min. gjashtë komora dhe tre mbyllje gome, me përforcim profili te çelikut (d=2mm), xham termopan me mbushje Argoni (4+16+4), dhe mekanizma hapje. Dera duhet te ankorohen me bulona te galvanizuar dhe çdo hapje mbi 2m duhet te shtangohet me profil te përforcuar te PVC-se. Vërejtje. Pozicioni përfshinë edhe harrnimin si nga pjesa e jashtme (fasada) dhe nga pjesa e mbrendshme rreth derës në hyrje të objektit - Të gjitha masat të mirren në vend. sipërfaqja llogaritet në m². Vërejtje: Të gjitha masat të mirren në vend ose percaktohen nga menaxheri i kontrates.	m2	1.00	145.00	145.00
7.3	Furnizimi dhe montimi i dyerve dritareve nga profilet e aluminit me urë termike . xham termopan me mbushje Argoni (4+16+4), dhe mekanizma për hapje mbyllje, kliper. Dritaret duhet te ankorohen me bulona te galvanizuar. Llogari për m². Dimensionet e deres ose dritares meren ne vend ,ose sipas kërkeses se menaxherit te kontrates.	m2	1.00	145.00	145.00
7.4	Mekanizem per dyer me veteteheqje, per mbyllje te deres	copë	1.00	35.00	35.00
7.5	Furnizimi dhe montimi i derës së hyrjes nga <u>profilet e aluminit me urë termike</u> , xham termopan me mbushje Argoni (4+16+4), dhe mekanizma për hapje mbyllje, kliper. Dera duhet te ankorohen me bulona te galvanizuar. Hapjet duhet te kenë mekanizma për hapje/mbyllje te vendosura ne atë mënyre qe te hapin edhe dritaren e epërme edhe atë te poshtme pernjehere, si dhe te mund te përdoret nga personi ne pozite te ngritur. Dimensionet e deres meren ne vend ,ose sipas kërkeses se menaxherit te kontrates.	m2	1.00	145.00	145.00
